

# **GFA Consulting Group GmbH - Dega Shqiptare**

**Pasqyrat Financiare Individuale  
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

Emërtimi dhe Forma ligjore	<b>GFA Consulting Group GmbH - Dega Shqiptare</b>
NUIS	L81406002K
Adresa e Selisë	Rr. Brigada e VII, Nr. 19, Tiranë
Data e regjistrimit	06/02/2018
Veprintaria Kryesore	Zbatimi i projektit të bashkëpunimit ndërkombëtar mbi zhvillimin ekonomik, promovimin e punësimit dhe trajnimin teknik dhe profesional.

# PASQYRAT FINANCIARE

( Në zbatim të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 2 dhe Ligj Nr. 25-2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", i ndryshuar )

**Viti**  
**2020**

Pasqyrat Financiare janë individuale	Po
Pasqyrat Financiare janë të konsoliduara	Jo
Pasqyrat Financiare janë të shprehura në	Leke
Pasqyrat Financiare janë të rrumbullkosura në	-
Periudha Kontabël e Pasqyrave Financiare	Nga 01.01.2020 Deri 31.12.2020
Data e mbylljes së Pasqyrave Financiare	23.07.2021

**Përmbajtja:**

	<b>Faqe</b>
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020	1
Pasqyra e performancës dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	3
Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	4
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare	5 – 13

# GFA Consulting Group GmbH - Dega Shqiptare

## Pasqyra e pozicionit financiar

më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lek)

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
<b>Aktivët</b>			
<b>I. Aktivët afatshkurtra</b>			
Mjete monetare	4	12,736,079	18,056,501
Të drejta të arkëtueshme	5	22,487,820	31,691,528
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	6	51,990	181,671
Aktive materiale të mbajtura për shitje	7	1,922,930	-
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>37,198,819</b>	<b>49,929,700</b>
<b>Aktivët afatgjata</b>			
Aktive materiale	8	-	-
Aktive jomateriale		-	-
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>37,198,819</b>	<b>49,929,700</b>
<b>Detyrime dhe kapitali</b>			
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Detyrime afatshkurtra	9	28,807,266	44,163,851
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>28,807,266</b>	<b>44,163,851</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Detyrime të tjera afatgjata		-	-
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>28,807,266</b>	<b>44,163,851</b>
<b>Kapitali dhe rezervat</b>			
Kapitali i nënshkruar	1	-	-
Fitimi (humbja) i pashpërndarë		5,765,849	(3,492,646)
Fitimi (humbja) e vitit		2,625,704	9,258,495
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>8,391,553</b>	<b>5,765,849</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>37,198,819</b>	<b>49,929,700</b>

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 13 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 u aprovuan nga drejtimi i Degës dhe u nënshkruan më 23 korrik 2021 si më poshtë:



Anja Radha Desai  
Përfaqësues ligjor

**GFA**  
CONSULTING GROUP  
GFA Consulting Group GmbH  
Eulienkrugstr. 82 · D-22359 Hamburg  
Tel.: +49 (0) 40 603 06-0

**GFA**  
CONSULTING GROUP  
Dega Shqiptare, NUIS: L81406002K



**HM&H BUSINESS Sh.p.k**  
NUIS: L31615002K  
Rr. Abdi Toptani, Nd. Torre Drin, Katl 4  
Tiranë, Shqipëri

Brumila Leskaj  
Kontabël i miratuar  
HM&H Business Sh.p.k.

# GFA Consulting Group GmbH - Dega Shqiptare

## Pasqyra e performancës dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lek)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Periudha e mbyllur më 31 dhjetor 2019
<b>Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit:</b>			
Të ardhurat nga shitja	10	117,472,048	154,317,539
Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces		-	-
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit		-	-
<b>Totali i të ardhurave nga aktiviteti i shfrytëzimit</b>		<b>117,472,048</b>	<b>154,317,539</b>
<b>Shpenzimet:</b>			
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		-	-
Shpenzime të personelit:	11		
<i>Paga dhe shpërblime</i>		(24,619,143)	(18,265,378)
<i>Shpenzime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore</i>		(2,318,089)	(1,892,292)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi		-	-
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	12	(85,821,875)	(123,067,255)
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>(112,759,107)</b>	<b>(143,224,925)</b>
Të ardhura të tjera		-	-
Zhvlerësimi i aktiveve dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra		-	-
<b>Të ardhurat dhe shpenzime financiare:</b>			
Të ardhura (shpenzime) nga interesat dhe të ngjashme, neto	13	(21)	(189)
Të ardhura (shpenzime) nga kursi i këmbimit, neto	14	(665,386)	(293,031)
<b>Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare</b>		<b>(665,407)</b>	<b>(293,220)</b>
Pjesa e fitimit (humbjes) nga pjesëmarrjet		-	-
Fitimi (humbja) para tatimit		4,047,534	10,799,394
Shpenzimi për tatimin mbi fitimin aktual	15	(1,421,830)	(1,540,899)
<b>Fitimi (humbja) e vitit</b>		<b>2,625,704</b>	<b>9,258,495</b>
<b>Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>			
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:</b>			
Diferencat nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja		-	-
Diferencat nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		-	-
Diferencat nga rivlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura për shitje		-	-
Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet		-	-
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>2,625,704</b>	<b>9,258,495</b>

Pasqyrat e Performancës dhe të Ardhurave Gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 13 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

## GFA Consulting Group GmbH - Dega Shqiptare

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lek)

	Kapitali aksionar	Fitime (humbje) të akumuluar	Totali
<b>Pozicioni më 31 dhjetor 2018</b>	-	(3,492,646)	(3,492,646)
Të ardhura (humbje) gjithëpërfshirëse për vitin:			
Fitimi (humbja) e periudhës	-	9,258,495	9,258,495
Të ardhura (humbje) të tjera gjithëpërfshirëse për periudhën	-	-	-
Të ardhura (humbje) totale gjithëpërfshirëse për periudhën	-	9,258,495	9,258,495
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:			
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	-	-	-
Dividendë të paguar	-	-	-
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike	-	-	-
<b>Pozicioni më 31 dhjetor 2019</b>	-	5,765,849	5,765,849
Të ardhura (humbje) gjithëpërfshirëse për vitin:			
Fitimi (humbja) e periudhës	-	2,625,704	2,625,704
Të ardhura (humbje) të tjera gjithëpërfshirëse për periudhën	-	-	-
Të ardhura (humbje) totale gjithëpërfshirëse për periudhën	-	2,625,704	2,625,704
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:			
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	-	-	-
Dividendë të paguar	-	-	-
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike	-	-	-
<b>Pozicioni më 31 dhjetor 2020</b>	-	8,391,553	8,391,553

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 13 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

## GFA Consulting Group GmbH - Dega Shqiptare

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare  
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lek)

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Periudha e mbyllur më 31 dhjetor 2019
<b>Fluksi monetar nga (përdorur në) veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		
Fitimi (humbja) e vitit para tatimit	4,047,534	10,799,394
Rregullime për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	592,586	245,945
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie (ritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	8,253,455	(4,048,875)
Rënie (ritje) aktivet materiale të mbajtura për shitje	(1,922,930)	2,679,553
Rritje (rënie) në detyrimet e pagueshme	(15,351,884)	5,232,850
Rritje (rënie) në detyrimet për punonjësit	-	-
Interesa të arkëtuara	-	-
Interesa të paguar	-	-
Pagesa për tatimin mbi fitimin	(987,610)	(3,610,884)
<b>Mjete monetare neto nga (përdorur në) veprimtaritë e shfrytëzimit</b>	<b>(5,368,849)</b>	<b>11,297,983</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga (përdorur në) aktivitetin e investimit</b>		
Pagesa për blerjen e aktiveve materiale	-	-
Të ardhura nga shitja e aktiveve materiale	-	64,000
<b>Mjete monetare neto nga (përdorur në) veprimtaritë e investimit</b>	<b>-</b>	<b>64,000</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga (përdorur në) aktivitetin e financimit</b>		
Arkëtime nga huatë	-	-
<b>Mjete monetare neto nga (përdorur në) veprimtaritë e financimit</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Rritje (rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë mjeteve monetare</b>	<b>(5,368,849)</b>	<b>11,361,983</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë mjeteve monetare më 1 janar</b>	<b>18,056,501</b>	<b>6,686,060</b>
Efekti i luhatjeve të kurseve të këmbimit të mjeteve monetare	48,427	8,458
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë mjeteve monetare më 31 dhjetor</b>	<b>12,736,079</b>	<b>18,056,501</b>

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 13 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

# GFA Consulting Group GmbH - Dega Shqiptare

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

---

### 1. Informacion i përgjithshëm

GFA Consulting Group GmbH - Dega Shqiptare (në vijim referuar si “Dega”) është një degë e shoqërisë së huaj GFA Consulting Group GmbH e regjistruar me Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) më datë 6 shkurt 2018.

Aktiviteti i Degës konsiston në zbatimin e projekteve të bashkëpunimit ndërkombëtar mbi zhvillimin ekonomik, promovimin e punësimit dhe trajnimin teknik dhe profesional.

Dega është e regjistruar me Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë me NUIS L81406002K.

GFA Consulting Group GmbH – Dega Shqiptare është degë e shoqërisë së huaj dhe nuk ka një kapital të vetin të nënshkruar dhe të regjistruar. Kapitali i regjistruar shoqërisë mëmë është 5,000,000 Euro.

Përfaqësues ligjor i Degës është Zj. Anja Radha Desai.

Selia kryesore e Degës deri më 12 mars 2020 ka qenë në Rr. Ibrahim Rugova, Sky Tower, Kati 12, Tiranë dhe në vijim është transferuar në adresën: Rr. Jeronim De Rada, Pall. Renis, Kati IV, Apt. 22, Tiranë. Me efekt nga 1 janari 2021, selia e Degës është transferuar në adresën: Rr. Brigada e VIII, Nr. 19, Tiranë. Dega gjithashtu ushtron veprimtari dhe në adresën dytësore Rr. Kristaq Fllogji, Lagjja nr. 18, 7001, Korçë.

Numri i të punësuarve të Degës më 31 dhjetor 2020 është 14 (31 dhjetor 2019: 9) ndërsa numrin mesatar i të punësuarve për vitin 2020 është 11 (2019: 9).

### 2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave

#### 2.1 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, të përmirësuara (SKK) dhe më konkretisht SKK 2.

#### 2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

#### 2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Degës.

#### 2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të kompanisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar, si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke pasur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga dega.

### 3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat të paraqitura në pasqyrat financiare.

#### 3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit.



# GFA Consulting Group GmbH - Dega Shqiptare

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
1 EUR	123.7	121.77

### 3.2 Instrumente financiare

Instrumentet financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentet financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentet e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentet financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse dega bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të degës mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur dega transferon aktivitetin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën dega angazhohet të blejë apo të shesë aktivitetin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktore të degës skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

#### *Paraja dhe ekuivalentët e parasë*

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

#### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se dega nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitorit të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

#### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### *Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv.

#### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

#### *Kapitali aksionar*

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

### 3.3 Aktive afatgjata materiale

#### (i) Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

# GFA Consulting Group GmbH - Dega Shqiptare

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

### (ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që dega do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

### (iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke përdorur metodën lineare të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material dhe duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka nuk amortizohet.

Metodat dhe përqindjet e amortizimit për secilën kategori aktivitetesh afatgjata për periudhën aktuale janë si më poshtë:

Përmirësim në qiramarrje	Mbi vlerën kontabël neto	5%
Mobilje dhe orendi	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Pajisje zyrash dhe informatike	Mbi vlerën kontabël neto	25%
Të tjera pajisje	Mbi vlerën kontabël neto	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

## 3.4 Zhvlerësimi

### (i) Aktivitetet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohen të burojnë nga aktiviteti.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivitetin financiar, të matur me kosto të amortizuara, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur më parë në kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuara, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### (ii) Aktivitetet jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të degës, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktiviteti tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

# GFA Consulting Group GmbH - Dega Shqiptare

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 3.5 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, dega ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar fluksin e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

### 3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

### 3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

### 3.8 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë periudhës.

## 4. Mjetet monetare

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Llogari rrjedhëse:		
Në Lek	12,118,358	16,326,458
Në Euro	452,423	1,505,021
	<u>12,570,781</u>	<u>17,831,479</u>
Arka:		
Arka në Lek	43,089	132,564
Arka në Euro	122,209	92,458
	<u>165,298</u>	<u>225,022</u>
<b>TOTALI</b>	<u><b>12,736,079</b></u>	<u><b>18,056,501</b></u>

## 5. Të drejta të arkëtueshme

Të drejtat e arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Të arkëtueshme nga klientët	5,054,592	31,005,759
Të arkëtueshme nga shoqëria mëmë për arkëtime	17,187,911	-
Parapagime për tatimin mbi fitimin	162,447	596,668
Paradhënie për të tretë	82,870	89,101
<b>TOTALI</b>	<u><b>22,487,820</b></u>	<u><b>31,691,528</b></u>

# GFA Consulting Group GmbH - Dega Shqiptare

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 6. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Garanci për qira	49,480	179,200
Parapagime për shpenzime	2,510	2,471
<b>TOTALI</b>	<b><u>51,990</u></b>	<b><u>181,671</u></b>

### 7. Aktive materiale të mbajtura për shitje

Aktivitet materiale të mbajtura për shitje më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Automjete	1,922,930	-
<b>TOTALI</b>	<b><u>1,922,930</u></b>	<b><u>-</u></b>

### 8. Aktive afatgjata materiale

Aktivitet afatgjata materiale më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 janë zero.

### 9. Detyrime afatshkurtra

Detyrimet afatshkurtra më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Të pagueshme ndaj furnitorëve	723,393	33,742,304
Parapagime për shërbime	16,328,400	-
Detyrime ndaj personelit	777,888	501,785
Detyrime tatimore:		
Tatim mbi vlerën e shtuar	9,952,177	9,396,560
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	450,141	265,865
Tatim mbi të ardhurat personale	456,137	207,634
Tatim në burim	119,130	49,703
<b>TOTALI</b>	<b><u>28,807,266</u></b>	<b><u>44,163,851</u></b>

### 10. Të ardhurat nga shitja

Të ardhurat nga shitja për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 përbëhen si më poshtë:

	<u>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Të ardhura nga zbatimi i projekteve	117,472,048	154,317,539
<b>TOTALI</b>	<b><u>117,472,048</u></b>	<b><u>154,317,539</u></b>

### 11. Shpenzimet e personelit

Kostoja e punës për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 përbëhet si më poshtë:

	<u>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Pagat dhe shpërblime	24,619,143	18,270,930
Shpenzime të sigurime shoqërore dhe shëndetësore	2,318,089	1,886,740
<b>TOTALI</b>	<b><u>26,937,232</u></b>	<b><u>20,157,670</u></b>

## GFA Consulting Group GmbH - Dega Shqiptare

### Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

#### 12. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Shpenzimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Energji elektrike	444,493	158,116
Shpenzime për materiale dhe pajisje për projektet	3,624,557	32,650,708
Qira për zyra	2,137,594	1,134,428
Shpenzime për mirëmbajtjen e automjeteve	133,798	349,634
Shpenzime për sigurimin e automjeteve	141,903	168,785
Të tjera shpenzime sigurimi	46,000	500
Shpenzime kancelarie	455,902	1,569,657
Shërbime ligjore	-	52,437
Shërbime noteriale	11,100	16,520
Shërbime përkthimi	17,752	3,500
Shpenzime të përgjithshme zyre	1,021,993	1,262,725
Shpenzime organizimi të workshop-eve	252,153	5,111,611
Shërbime konsulence për projektet	8,213,967	5,286,255
Shërbime konsulence nga shoqëria mëmë	16,176,002	11,148,699
Komisione ndërmjetësimi nga shoqëria mëmë	9,079,785	13,805,312
Konsulencë kontabël dhe fiskale	1,362,914	1,071,802
Rialokim i shpenzimeve nga shoqëria mëmë	39,115,361	39,928,269
Shpenzime për trajnime	-	2,100,128
Shpenzime akomodimi	950,511	2,773,552
Shpenzime për dieta	479,910	822,384
Shpenzime postare dhe komunikimi	487,797	501,262
Shpenzime transporti	1,256,071	2,366,137
Shpenzime për shërbimet bankare	69,829	130,354
Taksa dhe tarifa vendore	138,500	168,334
Taksa vjetore e automjeteve	5,701	-
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	135,010	446,541
Gjoha dhe dëmshpërblime	63,272	39,605
<b>TOTALI</b>	<b>85,821,875</b>	<b>123,067,255</b>

#### 13. Të ardhura (shpenzime) nga interesat dhe të ngjashme, neto

Të ardhura (shpenzime) nga interesat dhe të ngjashme, neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 në shumën 21 Lekë dhe 189 Lekë përkatësisht përbëhen nga shpenzime interesi nga llogaritë rrjedhëse të Degës.

#### 14. Të ardhura (shpenzime) nga kursi i këmbimit, neto

Të ardhurat (shpenzimet) nga kursi i këmbimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Fitime të realizuara nga kursi i këmbimit	56,073	103,240
Fitime të porealizuara nga kursi i këmbimit	728,520	677,156
	<b>784,593</b>	<b>780,396</b>
Humbje të realizuara nga kursi i këmbimit	(128,873)	150,326
Humbje të porealizuara nga kursi i këmbimit	(1,321,106)	923,101
	<b>(1,449,979)</b>	<b>1,073,427</b>
<b>TOTALI</b>	<b>(665,386)</b>	<b>(293,031)</b>

# GFA Consulting Group GmbH - Dega Shqiptare

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 15. Tatimi mbi fitimin

Dega është e regjistruar me organet tatimore shqiptare si biznes i madh me xhiro mbi 8 milion Lek dhe si e tillë është subjekt i tatimit mbi fitimin. Bazuar në legjislacionin shqiptar, norma e tatimit mbi fitimit për vitin 2020 është 5% për tatimpaguesit me qarkullim vjetor deri në 14 milionë Lek dhe 15% për tatimpaguesit me qarkullim vjetor mbi këtë shumë (2019: 15%).

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

#### (i) Shpenzimi i tatimit mbi fitimin aktual

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
<b>Fitimi/ (humbja) e periudhës para tatimit</b>	<b>4,047,534</b>	<b>10,799,394</b>
<i>Rregullime për veprimtari të përjashtuara:</i>		
Të ardhura nga veprimtari të përjashtuara	(58,563,842)	(100,244,664)
Shpenzime të veprimtari të përjashtuara	44,690,181	95,264,935
Parapagime të shtyra për qëllime kontabël	16,328,400	-
<b>Humbje (fitime) të përjashtuara, neto</b>	<b>2,454,739</b>	<b>(4,979,729)</b>
<i>Zëra shpenzimesh të panjohura:</i>		
Energji elektrike	444,494	158,116
Shpenzime për materiale dhe pajisje për projektet	58,262	51,288
Shpenzime për mirëmbajtjen e automjeteve	115,838	238,663
Shpenzime për sigurimin e automjeteve	141,903	168,786
Shpenzime kancelarie	17,919	31,557
Shërbime noteriale	-	1,120
Shërbime përkthimi	-	3,500
Shpenzime të përgjithshme zyre	673,314	585,421
Shpenzime organizimi të workshop-eve	-	21,000
Shpenzime për trajnime	-	244,128
Shërbime konsulence për projektet	137,689	1,131,642
Shpenzime akomodimi	670,176	606,434
Shpenzime për dieta	-	392,093
Shpenzime postare dhe komunikimi	164,589	139,114
Shpenzime transporti	465,358	471,407
Taksa dhe tarifa vendore	-	37,334
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	77,050	150,460
Gjoha dhe dëmshpërblime	10,000	15,377
Pagat dhe shpërblimet e personelit	-	5,552
<b>Totali i shpenzimeve të panjohura</b>	<b>2,976,591</b>	<b>4,452,992</b>
<b>Fitimi/(humbja) i tatueshëm</b>	<b>9,478,864</b>	<b>10,272,657</b>
<i>Norma e tatimit mbi fitimin</i>	<i>15%</i>	<i>15%</i>
<b>Shpenzimi i Tatimit mbi Fitimin</b>	<b>1,421,830</b>	<b>1,540,899</b>

Dega është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin për një pjesë të aktivitetit të saj bazuar në dispozitat e Marrëveshjes së datës 21 tetor 1988 ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik. Si rrjedhojë, për qëllime të llogaritjes së fitimit të tatueshëm vjetor dhe tatimit mbi fitimin, të ardhurat dhe shpenzimet të cilat lidhen me projekte realizuar në kuadër të kësaj marrëveshje janë paraqitur më lart në seksionin e "Rregullime për aktivitete të përjashtuara".

# GFA Consulting Group GmbH - Dega Shqiptare

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### Rikoncilimi i normës efektive të tatimit:

	2020	%	2019	%
<b>Fitimi/ humbja e periudhës para tatimit</b>	4,047,534	100.00%	10,799,394	100.00%
Tatim fitimi me shkallën tatimore standarde	607,130	15.00%	1,619,909	15.00%
<b>Rregullime:</b>				
Shtesa/(pakësime) të fitimit për qëllime tatimore, neto	368,211	9.10%	(746,959)	-6.92%
<b>Zëra shpenzimesh të panjohura:</b>				
Energji elektrike	66,674	1.65%	23,717	0.22%
Shpenzime për materiale dhe pajisje për projektet	8,739	0.22%	7,693	0.07%
Shpenzime për mirëmbajtjen e automjeteve	17,376	0.43%	35,800	0.33%
Shpenzime për sigurimin e automjeteve	21,286	0.53%	25,318	0.23%
Shpenzime kancelarie	2,688	0.07%	4,734	0.04%
Shërbime noteriale	-	0.00%	168	0.00%
Shërbime përkthimi	-	0.00%	525	0.00%
Shpenzime të përgjithshme zyre	100,997	2.50%	87,813	0.81%
Shpenzime organizimi të workshop-eve	-	0.00%	3,150	0.03%
Shpenzime për trajnime	-	0.00%	36,619	0.34%
Shërbime konsulence për projektet	20,653	0.51%	169,746	1.57%
Shpenzime akomodimi	100,526	2.48%	90,965	0.84%
Shpenzime për dieta	-	0.00%	58,814	0.54%
Shpenzime postare dhe komunikimi	24,688	0.61%	20,867	0.19%
Shpenzime transporti	69,804	1.72%	70,711	0.65%
Taksa dhe tarifa vendore	-	0.00%	5,600	0.05%
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	11,558	0.29%	22,569	0.21%
Gjoha dhe dëmshpërblime	1,500	0.04%	2,307	0.02%
Pagat dhe shpërblimet e personelit	-	0.00%	833	0.01%
<b>TOTALI</b>	<b>1,421,830</b>	<b>35.13%</b>	<b>1,540,899</b>	<b>14.27%</b>

(ii) E ardhura (shpenzimi) për tatimin e shtyrë

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 Dega nuk rezulton me të ardhura apo shpenzime nga tatimet e shtyra.

### 16. Transaksionet me palët e lidhura:

Transaksionet me palët e lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

(i) Të arkëtueshme nga palët e lidhura:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
GFA Consulting Group GmbH	17,187,911	-

(ii) Të pagueshme ndaj palëve të lidhura:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
GFA Consulting Group GmbH	-	33,421,346

(iii) Volumi i transaksioneve me palët e lidhura

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019
Alokim i shpenzimeve nga mëma tek Dega	39,115,361	39,928,269
Shërbime ndërmjetësimi nga mëma	9,079,785	13,805,312
Shërbime konsulence marrë nga mëma	16,176,002	11,148,699
Transferime nga mëma	65,994,971	97,273,414
Të arkëtueshme nga mëma për akëtim pjesor faturash	181,017,478	164,973,302

## **GFA Consulting Group GmbH - Dega Shqiptare**

### **Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

*(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

---

**17. Angazhime dhe pasiguri**

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Dega mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Degës, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Degës ose ndryshime në aktivet neto të saj.

**18. Ngjarje të mëpasshme**

Nuk ka asnjë ngjarje të mëpasshme pas datës së raportimit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.